

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRIMIN
Nr.faq/Br.sht: 603
Datë/Datum: 26.07.2018
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË , KOSOVO POLJE**



**DREJTORIA PËR ARSIM
Fushë Kosovë**

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës Nr.114 të dt. 11.06.2018 , mbështetur në kërkesën e banorëve të Miradisë së Epërme Nr. 02/070/05-0017135/ 18 të dt. 14.05.2018 , Drejtori i Drejtorisë për Arsim shpallë :

A N K A N D P U B L I K

Për rrënimin e objektit të vjetër të Shkollës fillore në Miradi të Epërme

KUSHTET : Objekti i vjetër i shkollës duhet të rrënohet plotësisht , duke përfshirë : kulmin , pllakën e betonit , të gjitha muret dhe themelet e objektit të shkollës .
Materiali komplet që rrënohet duhet të bartet në një vend të caktuar (sipas zgjedhjes që bën ofërtuesi).

Materiali nuk duhet të vendoset në vende që pengojnë qytetarët apo bizneset dhe krejt përgjegjësinë e merr operatori që kryen rrënimin e objektit .

Operatori për punën që kryen , merr materialin ndërtimor që rrënohet : tjegullat, lëndët drusore , drrasat , bllokat , tullat etj.

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit që posedojnë mjete dhe kushte për të rrënuar objektin e vjetër të shkollës .

Komisioni i caktuar do të shqyrton të gjitha kërkesat dhe do të zgjedhë operatorin .

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë nga dita e shpalljes .

Kërkesat dorëzohen në shkollën ; SHFMU"Vëllëzërit Frashëri " Miradi e Poshtme , Komuna e Fushë Kosovës .

